MARRËVESHJE PËR HAPJEN DHE PASTRIMIN SEZONAL TË KANALEVE TË UJITJES SË TOKAVE BUJQËSORE NË KOMUNËN E DEÇANIT

E lidhur në lokalet e Komunës së Deçanit me dt. 11 Maj 2018, në mes të palëve:

1. Komuës së Deçanit, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës , z.Bashkim Ramosaj, në njërën anë.

   Dhe

2. Kompania Rajonale e Ujitjes(KRU) "Drini i Bardhë" SH.A. me seli në Pejë, të cilën e përfaqëson,z.Bedri Haxhijaj, Kryeshef Ekzekutiv, nga ana tjetër.

OBJEKTI I MARRËVESHJES

Neni 1.

Objekt i kësaj Marrëveshje është hapja dhe pastrimi sezonal i kanaleve të ujitjes së tokave bujqësore të Komunës së Deçanit, sipas projekteve të prezantuara.

OBLIGIMET E KOMUNËS

Neni 2.

Komuna e Deçanit sipas kësaj marrëveshje ka për obligim:

- Që nga buxheti komunal përkatësisht nga Linja buxhetore e Drejtorisë për BPZHR të bëjë derdhjen e mjeteve financiare në vlerë prej 15,000.00 €, në xhirollogarinë e KRU "Drini i Bardhë"Sh.A., për hapjen dhe pastrimin e kanaleve të ujitjes.
- Projektin detal për hapjen dhe pastrimin e kanaleve të ujitjes tia ofroj Kompanise për ti kryer punët sipas projektit.
- Të caktoj mbikqyrsin për përcjelljen e realizimit të projektit.
- Pas përfundimit të punimeve të caktoj komisionin për pranimin e punëve.
- Përmes organeve Komunale përkatëse të mundësoj realizimin e projektit pa pengesa, duke përfshirë mosmarrëveshjet eventuale të paraqitura mes banorëve dhe Kompanisë.

OBLIGIMET E KRU"DRINI I BARDHË"SH.A.

Neni 3.

Kompania Rajonale e Ujitjes ka për obligim:

- Të zbatoj projektin në tërësi, në pajtim me përshkrimin teknik të përcaktuar në projekt.
- Të bëjë angazhimin e fuqisë punëtore sipas nevojës.
- T'i mundësoj Drejtoris për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural përcjelljen e realizimit të projektit.

- Të njoftoj me kohë organet përkatëse të Komunës:Drejtorin për BPZHR apo Zyrën e Prokurimit për çdo pengesë eventuale të paraqitur gjatë realizimit të këtij projekti.
- T'i përfundoj të gjitha punët siq janë përshkruar në projekt brenda afatit kohor prej 45 (dyzet e pes) ditëve nga dita e fillimit të punimeve.
- Të zbatoj në tërsi Projektin detal ekzekutiv për hapjen dhe pastrimin e kanaleve të ujitjes.
- Pas përfundimit të punimeve të njoftoj Komunën për kryerjen e punëve.

OBLIGIMET E PËRBASHKËTA

Neni 4.

Palët e kësaj Marrëveshje do të angazhohen që të gjitha obligimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje t'i zbatojnë me përpikëri.

Palët në Marrëveshje për çdo paqartësi apo vërejtje në zbatimin e obligimeve që dalin nga kjo Marrëveshje komunikojnë mes veti në formë të shkresave zyrtare.

NDRYSHIMI I MARRËVESHJES

Neni 5.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet apo modifikohet nëse të dy palët pajtohen.Ndryshimi bëhet në formë të shkruar dhe është aneks i kësaj Marrëveshje.

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 6.

Pas përfundimit të punëve të përcaktuara në këtë projekt në tërësi nga ana Zyrës së Prokurimit do të formohet Komisioni për pranimin e punëve.

Neni 7.

Kjo Marrëveshje shkëputet me realizimin përfundimtar të projektit, mirpo mund të shkëputet edhe para afatit nëse palët nuk u përmbahen obligimeve që dalin nga kjo marrëveshje.

Neni 8.

Në rast të mosmarrëveshjeve eventuale palët do të përpiqen që të njëjtat t'i zgjedhin përmes bisedimeve të ndërsjella.Në rast se palët nuk arrijnë që mosmarrëveshjet ti zgjedhin me mirëbesim, atëherë për zgjidhjen e kontestit kompetent është Gjykata Themelore Pejë-Dega në Deçan.

Neni 9.

Kjo Marrëveshje është e hartuar në 4 kopje origjinale identike.

Neni 10.

Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët në marrëveshje.

E nëshkruar në Deçan, me dt.11 Maj 2018.

Palët nënshkruese të Marrëveshjes:

Për KRU "Drini I Bardhë"Sh.A.
Kryeshefi Ekzekutiv:
Bedri Haxhijaj

Kompania Rajonale e Ujitjes Drini i Bardhë 600237524 Pejë Shoqëri Aksionare

Për Komunën e Deçanit
K r y e t a r i:
Bashkim Ramosaj

BASHKIA-OPSTINA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DECANE - DECANI MUNICIPALITY
Faqe 2 nga 2
Nr. Prot. 13781
Data: 11.05.18
Nr. i faqeve: 02
DEÇAN DECANI